



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
MINISTRI

## UDHËZIM

Nr. 1192, datë 13/2 /2017

### **PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 179, DATË 11/01/2017, “PËR DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT DHE PROCEDURAT E INSPEKTIMIT, PEZULLIMIT DHE REVOKIMIT TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË UDHËTIMIT DHE OPERATORIT TURISTIK”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Nenit 48 dhe 51 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, të nenit 16, pika 3 dhe nenit 19 të ligjit nr. 10081, date 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 538, date 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta të Këshillit të Ministrave,

## UDHËZOJ:

1. Në pikën 2, germa “a”, ndryshohet si më poshtë:
  - a) Diplomën universitare të ciklit të parë të studimeve në fushën e turizmit / historisë / arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore / administrim biznesit / gjeografisë të lëshuar nga universitete brenda ose jashtë Shqipërisë ose diplomë e lëshuar nga IATA në fushën e turizmit ose diplomën e shkollës së mesme profesionale për turizëm ose çdo diplomë kualifikimi profesional në fushën e turizmit, për drejtuesin teknik ose përfaqësuesin ligjor (administratorin). Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga Ministria përgjegjëse për Arsimin. Dokumentat e lëshuara jashtë shtetit duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuara/apostiluara.
2. Në pikën 4, germa “a”, ndryshohet si më poshtë:
  - a) Diplomën universitare të ciklit të parë të studimeve në fushën e turizmit / historisë / arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore / administrim biznesit / gjeografisë të lëshuar nga universitete brenda ose jashtë Shqipërisë ose diplomë e lëshuar nga IATA në fushën e turizmit, për drejtuesin teknik dhe përfaqësuesin ligjor (administratorin). Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga Ministria përgjegjëse për Arsimin. Dokumentat e lëshuara jashtë shtetit duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuara/apostiluara.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI  
  
MILVA EKONOMI